

## RAPORT MBI PËRDORIMIN E FONDEVE BUXHETORE

### PËR RINDËRTIMIN VITI 2020

Ligji nr.88/2019 “Për Buxhetin e vitit 2020” miratoi Fondin e Rindërtimit në masën 20 miliardë lekë në nivel total vjetor, ndërkohë që Neni 7 përcakton përdorimin i tij si më poshtë:

*“Fondi i Rindërtimit prej 20 miliardë lekë, i cili përdoret për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, përbëhet nga:*

- *Grante 7 miliardë lekë*
- *Shpenzime të buxhetit të shtetit 13 miliardë lekë*

*Fondi prej 20 miliardë lekë, shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi, të miratuar në tabelën 1, të nenit 11 të këtij ligji.*

*Çdo e ardhur në formë granti me destinacion përballimin e pasojave të tërmetit, mbi tavanin prej 7 miliardë lekë, rrit në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit të Rindërtimit, duke shtuar kufijtë e përcaktuar në nenin 1, 2, 8 dhe 11, si dhe kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, të nenit 11, të këtij ligji.*

*Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara trashëgohen në vitin pasardhës dhe përdoren për të njëjtin qëllim.*

*Mënyra e përdorimit të Fondit të Rindërtimit, programet buxhetore ku do alokohet fondi si dhe institucionet dhe agjencitë, zbatuese të tij, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave”.*

- Me Aktin Normativ nr. 6, datë 21.03.2020, në nenin 4 të tij, është miratuar ndryshimi si më poshtë:

*“Në nenin 7 paragrafi i tretë riformulohet si vijon: “...Fondi prej 20 miliardë lekë, shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi, të miratuar në tabelën 1, të nenit 11 të këtij ligji, si dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar të miratuar në tabelën 3, të nenit 15 të këtij ligji”.*

- Me Aktin Normativ nr. 28, date 2.07.2020, është miratuar ndryshimi si më poshtë:

*Në nenin 7, Fondi i Rindërtimit ndryshohet dhe bëhet “... 34 miliardë lekësh...” dhe nëndarjet e dytë dhe e tretë ndryshohen si vijon:*

- “- *Grante 3 miliardë lekë.*
- *Shpenzime të buxhetit të shtetit 31 miliardë lekë.”*

- Me Aktin Normativ nr. 34/2020, janë miratuar Fondet e Rindërtimit gjithsej për *32 miliardë lekë* i ndarë si më poshtë:
  - “ - *Grante 3 miliardë lekë.*
  - *Shpenzime të buxhetit të shtetit 29 miliardë lekë”.*

Gjatë vitit 2020, në zbatim të Vendimeve të Këshillit të Ministrave, për procesin e rindërtimit janë akorduar fonde si më poshtë:

1. Nga fondi i planifikuar prej 29 miliardë lekësh nga Shpenzimet e buxhetit, janë akorduar 25 766 256 mijë lekë. Nga këto:
  - *405 970 mijë lekë, janë akorduar per shpenzime korrente për Njësitë e Qeverisjes Qendrore.*
  - *10 451 539 mijë lekë janë akorduar shpenzime për investime për Njësitë e Qeverisjes Qendrore*
  - *14 908 747 mije leke janë akorduar si trasferte e pakushtëzuar për Njësitë e Qeverisjes Vendore.*
2. Nga fondet grante të parashikuara prej 3 miliardë lekësh janë shpërndarë në zbatim te VKM-ve rreth 2 311 738 mijë lekë .

Në mënyrë të detajuar fondet e akorduara sipas VKM-ve, paraqiten në tabelën “Përdorimet e Fondit të Rindërtimit për vitin 2020”.